



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Mbledhja nr.11/24

Prishtinë, më 22.5.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani dhe Avdullah Hoti, Mërgim Lushtaku, Ferat Shala, Duda Balje dhe Pal Lekaj.

Të ftuar: Hekuran Murati, Amir Zylfiu, BQK, Zyber Çadraku, BQK, Hajrije Morina, ARRU, Ramiz Krasniqi, ARRU, Mentor Hyseni, AKP, Arben Limani, AKP, Adem Selishta, AKP, Xhevdet Neziraj, AKP, Avni Ajdini, AKP dhe Hasim Muçolli, AKP.

Pjesëmarrësit tjerë: Diar Beqaj, D+, Naim Jakaj, IKD, Melos Kolshi, IKD, Valmire Abdullahu, EO, Sami Gashi, GPLVV.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, dhe Diar Beqaj, praktikant në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë, 3 dhe 24 prill 2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;**
- 5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr. 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;**
- 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-304 për Bankat;**
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullativ të Shërbimit të ujit për vitin 2023;**
- 8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2023;**
- 9. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari: Para se të miratojmë rendin e ditës, propozoj edhe katër pika shtese të rendit të ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion Kulturë Rini dhe Sport për Projektligjin nr.08/L-277 për Sport;

2. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion Kulture Rini dhe Sport për Projektligjin për Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë.

3. Raport me rekomandim, lidhur me Projektligjin nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për Programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;

4. Raport me rekomandim, lidhur Projektligj nr. 08/L-308 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për Programin e financave publike dhe rritjen ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar.

Kryetari, konstatoi që me shumice votash, Komisioni miratoi rendin e ditës, me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 3 dhe 24 prill 2024;

Kryetari, pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë ndonjë vërejtje në procesverbalet e datës **3 dhe 24 prill 2024**, pasi nuk pati vërejtje e vendosi ne votim miratimin e procesverbaleve dhe konstatoi se miratohen procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të mbajtura më datë **3 dhe 24 prill 2024** (pa vërejtje).

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes për Projektligjin nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përmban implikime buxhetore por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, Projektligji nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues përmban implikime buxhetore por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr. 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor nuk përmban implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, për Projektligjin nr. 08/L-241 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-304 për Bankat;**

Kryetari: Para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare, Komisioni përgjegjës raportues e shqyrton Projektligjin në parim dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar në Kuvend Projektligjin për Bankat. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, si Komision funksional, është ngarkuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë një raport me rekomandime. Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është rregullimi i aktivitetit bankar dhe financiar të bankës dhe të bankave në Republikën e Kosovës, në funksion të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi të qëndrueshëm financiar, duke siguruar një nivel të duhur të mbrojtjes së interesave të depozitarëve. Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës e kemi ftuar ministrin e Financave, zoti Hekuran Murati, si ministri sponsorizuese.

Hekuran Murati: Faleminderit, i nderuar kryetar. Të nderuar deputetë, anëtarë të komisionit, Projektligji për Banka, pra që është para jush, ka për qëllim të rregullojë aktivitetin bankar dhe financiar të bankave në Republikën e Kosovës në funksion të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi të qëndrueshëm financiar, duke siguruar nivel të duhur të mbrojtjes së interesave të depozitarëve përmes rregullimit të kriterëve për themelimin dhe licencimin e bankave, organizimin dhe menaxhimin e shëndoshë të sektorit, mbikëqyrjes potenciale të bankave, si dhe rimëkëmbjes, përmbylljes apo edhe likuidimit në rast nevojë. Ky projektligj po ashtu, synon të harmonizojë kornizën ligjore për bankat edhe me aktet të

Bashkimit Evropian, pra është rregullorja mbi kërkesat për institucionet kreditore dhe shoqëritë investuese është direktiva për qasje në veprimtarinë e institucionit kreditor dhe mbikëqyrja e institucionit kreditor dhe shoqërisë investuese dhe direktiva për themelimin e kornizës së rimëkëmbjes dhe përmylljes së institucioneve kreditore dhe shoqërive investuese. Projektligji, pra zbatohet për të gjitha bankat, përfshirë edhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, Bordin e drejtorëve, menaxherët e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre, si dhe zbatohet edhe për aspektet e kontabilitetit dhe sistemit të raportimit financiar të bankave, përfshirë kërkesat e auditimit. Ligji në tërësi përbëhet nga njëqindpesëdhjetë nene, ndarë në katër kapituj, të cilët pra janë të ndarë edhe në kapitujt përkatës.

Ndryshimet kryesore në kuadër të këtij projektligji në krahasim me ligjin e kaluar, pra janë si në vijim, fillimisht është bërë ndarja sepse në të kaluarën ka qenë Ligji për banka dhe institucionet financiare jobankare, kurse tani ato rregullohen me ligj të veçantë, kurse aktualisht është vetëm Ligji për banka ka shtim të përkufizimeve, që lidhen me dispozitat e këtij ligji, janë shtuar autorizimet mbikëqyrëse në fushën e mbrojtjes së konsumatorit lidhur me produktet dhe shërbimet bankare e financiare, janë shtuar veprimtari financiare që mund të ushtrojnë bankat dhe shërbimet financiare ndihmëse, janë shtuar kriteret për licencim të veprimtarive dhe pozitive kyçe për qeverisjen e bankave. Është rritur kërkesa për kapital themeltar në 10 milionë euro nga 7 sa ishte më parë.

Jeta Statovci: Faleminderit, i nderuar ministër, një prej argumenteve që përmendet ishte edhe çështja e rritjes së parakushteve për kapitalin themeltar. Desha të di pak a shumë për arsye dhe motive, ta kërkoj që banka me qenë më me likuiditet apo për të tentua me tërheq investitorë më serioz, sensin që kanë, pra gatishmëri për një investim më të lartë se sa parakushtet fillestare që kanë

qenë, e dyta përmendët që ligji bën një theks edhe tek masa në raport me mbrojtjen e konsumatorit, nëse mund të ndash, pra cilat prej atyre masave që bëjnë diferencë nga ligji paraprak janë si vlerë e shtuar në këtë ligj edhe në raport me institucionet e mikrofinancave, parashihet që të bëhen me ligj tjetër, apo si është menduar që të procedohet tutje?

Hekuran Murati: Faleminderit për pyetjen, e nderuar deputete!

Tani kam edhe përfaqësuesit e Bankës Qendrore, meqenëse kanë qenë pjesë e grupit punues për hartimin e projektligjit dhe besoj se nëse ka edhe nevojë për detaje shtesë, mund të përgjigjen. Në lidhje me pyetjet e deputetes, pra fillimisht ishte çështja e rritjes së nevojës për kapitalin themeltar në nivel 7 milion, konsideroj që ka qenë çështje e kohës, për shkak se niveli i tillë i është caktuar pra më shumë se një dekadë më herët dhe tani rrethanat kanë ndryshuar, është edhe nevojë që të ketë likuiditet, por edhe të ketë sistem, pra banka të jetë e qëndrueshme dhe që kanë kapital serioz prandaj është parapa edhe rritja. Sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve, besoj që përfaqësuesit mund të shtojnë, mund të plotësojnë, por fillimisht është qartësua, megjithëse BQK-ja tashmë ka një rregullore në fuqi sa i përket llogarisë bazike, për shërbime bazike. Tani është ë përforcuar edhe më tej baza ligjore, sa i përket kësaj çështjeje dhe janë shtuar edhe disa dispozita tjera që sigurojnë mbrojtjen e konsumatorit apo depozitarit në këtë rast.

Kurse pyetja për mikrofinancat, po, është e saktë ashtu siç e thotë, pra parashihet që përmes një ligji tjetër, për të cilin jemi duke punuar paralelisht me mbështetjen edhe të IFC-së, pra International Financial Corporation,ww, që besoj shpejt do ta sjellim edhe atë ligj para jush për miratim, pra parasheh edhe ai rregullim të veçantë ndaras nga ky ligj.

Kryetari, pas përfundimit të diskutimeve konstatoi se Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Të miratohet në parim Projektligjit nr.08/L-304 për Bankat.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullativ të Shërbimit të ujit për vitin 2023

Kryetari, njoftoi se për këtë pike janë ftuar përfaqësuesit e Autoriteti, të cilët do ta prezantojnë raportin vjetor për vitin 2023.

Hajrije Morina: Përshëndetje të nderuar deputetë. Sa i përket ARRU-së, buxheti total për vitin 2023 ka qenë diku rreth 392,000 Euro, i cili është i ndarë në tri vija buxhetore: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale. Prej këtij buxheti, janë shpenzua gjithsej 88.75% e buxhetit të paraparë, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit që është ka qenë e paraparë për të realizua një projekt për verifikimin e infrastrukturës për matje të ujit te konsumatorët në Kosovë, një buxhet prej 30,000 Eurove, nuk kemi pasur mundësi me i realizua, për shkak se kemi pasur një kërkesë nga sinjalizuesi që ky projekt është konflikt interesi, konflikt nuk mundet për shkak se dëmet që i marrim prej KRRU-ve, nuk mund t'ia japim një operatori privat dhe me dalë në terren e mi verifikua ato. Ka qenë njëfarë konflikti ligjor, për arsye se nuk patëm mundëso t'a realizojmë këtë projekt, meqë atë këtë vit u shpenzua më pak sesa viteve tjera në përgjithësi.

Të hyrat e ARU-së, këtë vit i kanë qenë të planifikuara me u realizua mbi katërqindnjë mijë euro. ndërsa inkasimin e kemi pasur 99,09% e kemi realizua, po kemi realizua edhe inkasim të borxheve të vjetra me ç'rast është rritur vlera e të hyrave që u planifikua me arrit në vend 401,000 Euro, përafërsisht kemi realizua 440,000 Euro të hyra.

Edhe këto çështje, sfidat e ARU-së, unë dje pak e kam përmendë çështjen e pagave dhe stafit, ndoshta shkurtimisht veç po e cekim. Unë e kam shumë të qartë

që politika të Qeverisë është që momentalisht mos me u rritë stafi i institucioneve të vendit, mirëpo, së paku ju kisha lutur ta rishikoni edhe një herë, çështjen e koeficienteve të stafit të rregullatorit të ujit, unë mendoj se është një padrejtësi aty është një padrejtësi, unë kam nevojë të kem një staf të motivuar.

Kryetari konstatoi se nuk pati kuorum për votimin e kësaj pike, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2023,

Kryetari, njoftoi qe për këtë pikë të rendit të ditës janë ftuar përfaqësuesit e AKP-së, të cilët do ta prezantojnë raportin vjetor për vitin 2023.

Mentor Hyseni: AKP-ja ka vazhduar edhe këtë vit me menaxhimin financiar të aktivitetit të saj dhe ka arritur që të shpenzojë diku 94.25% të buxhetit. Edhe pse ka arritje të aktiviteteve operative të saj, megjithatë ka arritur të bëjë zvogëlimin e shpenzimeve të përgjithshme, duke e kursyer kështu buxhetin e saj në përgjithësi, vetëm në zvogëlimin e shpenzimeve, në vitin 2023, në krahasim me 2020, kur ne e kemi marrë mandatin. Zvogëlimi i shpenzimeve është diku rreth 27% të buxhetit, apo 2 milionë për vit, ose për këto 3 vite, 5,1 milion kursime. Vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, për këto 2 vite AKP-ja ka ulë shpenzimin diku 33,65% apo në vlerë 1,7 milion. Gjithashtu, me ristrukturimin e zyrave rajonale të Arkivit që e kemi bërë grumbullimin e tyre dhe po shkojmë përmes procesit të digjitalizimit, 118,000 Euro i kemi kursye në muaj, apo për këto 2 vitet e fundit, diku 350,000 euro.

Kryetari: Sa i përket pagave të stafit, ju e dini që ka pasur një vendim të Kuvendit edhe të Bordit të Agjencisë për zbritje të pagave për 30%. Ai vendim

është ankimi dhe pastaj tek në fund të vitit 2023, pas shterimit të gjitha ankimeve të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil konkluduar që vendimi ka qenë i ligjshëm edhe ai do të zbatohet. Nëse mund të na tregoni për zbatimin e kësaj dhe shifrat e sakta?

Mentor Hyseni: Ne thamë edhe më herët që vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditje kemi ulë diku 33.65% apo 1.7 milion, kemi përsëri për uljen e pagave dhe mëditjes. Këto kanë qenë dy vendime që i ka marrë Bordi. Fillimisht e kam marrë uljen e pagës së anëtarëve të Bordit, prej 30% edhe mandej kemi dhënë urdhër që menaxhmenti të konsiderojë uljen në gjeneral 30% të pagave të punëtorëve, por, ka kryesisht një përqindje më e madhe të merret me stafin më të lartë menaxherial, e stafi i ulët diku ka pasur 5% ulje, stafi i lartë menaxherial, ka shkua deri në 36%.

Mërgim Lushtaku: Më bëri përshtypje në raportin që e keni dërgua, ku thuhet që gjatë vitit 2022 keni angazhuar tetë persona jashtë listës së pagave.

Pse atje keni këto angazhime? Për çka dhe çfarë lloj të kontratave dhe si ka shkua procedura?

Mentor Hyseni: Pasi që ka informacion shumë më detaj në atë aspekt. Ofrues të shërbimeve nuk janë punëtorë shërbyes civilë, që trajtohen me Ligjin e pagave ose Ligjin për shërbyes civilë, janë punëtorë të NSH-ve, ish-ndërmarrjeve shoqërore edhe zakonisht shumica e tyre, i nderuari deputet, janë roje nëpër shumicën e ndërmarrjeve shoqërore që i kemi ne. Ata e kanë pasur një pagë 350 Euro.

Megjithatë, kemi mbërri me një ulje të shpenzimit prej 1.3 milion. Pra, e kemi zvogëluar numrin e punëtorëve, i kemi ristrukturua ato që kanë mbetur kemi thënë nuk ia vlen mu pagua me 350 euro, por duhet me u pagua me një pagë më me dinjitet.

Unë e di që nuk mjafton, se na i kemi punëtorët e NSH-ve që i menaxhon AKP-ja edhe punëtorët, si shërbyes publikë ose shërbyes civilë që paguan pesëfish edhe për këtë pjesë unë kisha me thanë që ndoshta është më e mira që e kemi për këtë pjesën e këtyre përgjigjeve.

Mentor Hyseni: AKP-ja ka vazhduar edhe këtë vit me menaxhimin financiar të aktivitetit të saj dhe ka arritur që të shpenzojë diku 94.25% të buxhetit. Edhe pse ka arritje të aktiviteteve operative të saj, megjithatë ka arritur të bëjë zvogëlimin e shpenzimeve të përgjithshme, duke e kursyer kështu buxhetin e saj në përgjithësi, vetëm në zvogëlimin e shpenzimeve, në vitin 2023, në krahasim me 2020, kur ne e kemi marrë mandatin. Zvogëlimi i shpenzimeve është diku rreth 27% të buxhetit, apo 2 milionë për vit, ose për këto 3 vite i 5,1 milionë kursime. Vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, për këto 2 vite AKP ka ulë shpenzimin diku 33,65% apo në vlerë 1,7 milionë. Gjithashtu, me ristrukturimin e zyrave rajonale të Arkivit që i kemi bërë grumbullimin e tyre dhe po shkojmë përmes procesit të digjitalizimit, 118,000 Euro i kemi kursye në muaj, apo për këto 2 vitet e fundit diku 350,000 euro.

Kryetari konstatoi se nuk ka kuorum për tu hedhur në votim, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër.

9. Raport me rekomandim, lidhur Projektligj nr. 08/L-308 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për Programin e financave publikë dhe rritjen ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar.

Kryetari, konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

1. Të miratohet Projektligji nr.08/L-308 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për Programin e financave publikë dhe rritjen ekonomike ndërmjet

10. Raport me rekomandim, lidhur me Projektligjin nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për Programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;

Kryetari, konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

1. Të miratohet Projektligji nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për Programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

11. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin nr.08/L-277 për Sport;

Kryetari, konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1.Projektligjin nr.08/L-277 për Sport përmban implikime buxhetore por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional, për **Projektligjin nr.08/L-277 për Sport** nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

12. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion Kulturë Rini dhe Sport për Projektligjin për Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë

Kryetari, konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- 1. Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë** përmban implikime buxhetore, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, për për **Projektligjin nr.08/L-264 për Rininë** nuk përmbajnë implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

13. Të ndryshme.

Për këtë pikë, nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Armend Muja,
Kryetar i Komisionit